



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

*Ministria e Punëve të Brendshme/Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/Ministry of Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost  
Kosovo Academy for Public Safety

Në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, **Akademia e Kosovës për Siguri Publike**, ri shpall këtë:

**KONKURS**  
**për plotësimin e vendit të punës**

<b>Pozita:</b>	Mjek i praktikës së përgjithshme
<b>Nr. i references:</b>	AKSP-56/2018
<b>Numri i vendeve të punës:</b>	1 (një)
<b>Paga bazë (bruto):</b>	543.76 €
<b>Orari i punës:</b>	I plotë

**Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës:** Nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësin e Udhëheqësit të Divizionit të Shërbimeve të Përgjithshme, është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve mjekësore për vijuesit e trajnimeve dhe arsimin të lartë në akademi, si dhe personave tjerë që marrin pjesë në punë dhe aktivitete që lidhen direkt me akademinë.

**Detyrat dhe përgjegjësit kryesore**

1. Ofrimi i shërbimeve mjekësore në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;
2. Përcaktimi i diagnozës dhe ofrimi i terapisë adekuate;
3. Referimi i pacientëve për në QE & QKUK;
4. Përkrahja në realizimin e trajnimeve përmes demonstrimit të ofrimit të ndihmës së parë;
5. Realizimi i vizitave mjekësore në hapësirat ku zhvillohen aktivitete sportive dhe në hapësirat tjera të akademisë sipas kërkesave të palëve;
6. Menaxhimi i punës në Sektorin Mjekësor dhe mbikëqyrja e teknikëve/infermierëve;
7. Përgatitja e raporteve javore, mujore dhe vjetore, dhe përcjellja e protokollit ditor mjekësor;
8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm e që kërkohen kohë pas kohe nga Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimeve të Përbashkëta.

## **Shkollimi dhe përvoja e kërkuar**

- Përgatitje Universitare – Mjekësi e Përgjithshme (e obligueshme).
- Certifikata e licencimit (e obligueshme).
- Stazhi i punës sipas kërkesave të ligjit (e obligueshme).

## **Aftësia, dhe atributet tjera që kërkohen**

Njohuri të mira të punës me kompjuter, në programet Microsoft Word, Excel, Power Point. Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe brenda afateve të kufizuara kohore, aftësi për të punuar me njerëz të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, gjinisë dhe pikëpamjeve të ndryshme politike duke ruajtur paanshmërinë dhe objektivitetin, vet-iniciativë dhe përkushtim i vëmendjes ndaj detaleve dhe aftësi për të punuar në një ambient ekipor. Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare (e obligueshme).

## **Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin**

Përzgjedhja e mjekut të praktikës së përgjithshme, bëhet në pajtim me Ligjin e Punës Nr.03/L-212, si dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

## **Kohëzgjatja e emërimit**

Konform Ligjit të Punës Nr.03/L-212, periudha provuese gjashtë (6) muaj.

## **Data e mbylljes së konkursit**

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit, duke filluar nga data 23.07.2018 deri me datën 06.08.2018, në ora 16:00.

## **Paraqitja e kërkesave**

Aplikacionet dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike – Vushtrri. Aplikacionit i bashkëngjitet një cv profesionale dhe kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohet për vendin e punës për të cilin konkurroni. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet nga ueb faqja e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike: <http://www.aksp-ks.net/>.

***Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.***

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen

Për informata me te hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit nr. tel: 028 590 070 Ext 210 ose 211, prej orës 08:00 - 1600.